



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 323, datë 25.10.2021

**PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË PËR  
POZICIONET E DREJTUESVE NË PROKURORITË PRANË GJYKATAVE  
TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJE, POGRADEC, SARANDË DHE NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË APELIT DURRËS.**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 20, pika 8 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Mbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionet e Drejtuesve në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Lushnje, Pogradec, Sarandë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës., sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GËNT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**